



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

(Rasti UNIQA International GmbH- SIGAL Holding SH A)

Në datën 19 Dhjetor 2007, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sipas së cilit shoqëria UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH (Uniqa) me seli në Vienë, Austri, përfton kontroll nga blerja e 45.62 % të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës në shoqërinë Sigal Holding Sh.A.

Ky transaksion, sipas marrëveshjes së transferimit të aksioneve, nënshkruar nga palët pjesëmarrëse, është kryer në datën 17 Dhjetor 2007.

1. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse është:

- Për UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH: pjesëmarrje dhe manaxhim të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit;
- Për Sigal Holding Sh.A: Ushtrim i veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit jetë dhe jo-jetë në tregun kombëtar dhe nëpërmjet filialeve të tij në Kosovë dhe Maqedoni.

2. Nga shqyrtimi paraprak, Autoriteti gjeti, që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit dhe do t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit dhe në Rregullores “Për Zbatimin e procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”.

Autoriteti fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4 Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al